



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

C.nr.69/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Sabaheta Kurteshi dhe procesmbajtës Senida Nuri, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit, Kompania Kosovare për Distriubuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh.a (KEDS) Bulevardi Bill Kllinton nr.3 Prishtinë kundër të paditurit, R. A. me numër personal...., me vendbanim në K., pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor lidhur me padinë për kompensimin e dëmit material , pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor të datës 20.10.2023, gjykata me datë 20.11.2023 vendosi dhe mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ne tërësi kërkesëpadia e paditësses Kompania Kosovare për Distriubuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh.a/KEDS Bulevardi Bill Kllinton nr.3 Prishtinë/ SI KERKESË E BAZUAR , ku obligohet pala e paditur Rr. A. me numër personal..., me vendbanim në K., Komuna e Dragashit që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 4,869,74 euro (katërmijë e tetëqindtë e gjashtëdhjetë e nënte euro e shtatëdhjetë e katër cent) me kamat ligjore prej 8% duke filluar që nga prurja e këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto e paditura duhet t’i paguaj brenda 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcënim ekzekutimi.

OBLIGOHET i padituri që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 190 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqësve

Pala paditëse me dt.20.10.2020 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë me objekt kontesti kompensimin e dëmit material në shumën prej 4,869.74 euro), pasi që i padituri me veprimet e tij të paditurës i ka shkaktuar dëm e për të cilin i njëjti është dënuar dhe në procedurën penale sipas Aktgjykimit P.nr. 114/16 të datës 21.03.2018

Me Aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.,69/20 te datës 06.02.2022 gjykata e ka obliguar të paditurin që të deklarohet lidhur me padinë e parashtruar të cilat shkresa i ka pranuar me datë 04.01.2023 e i cili nga ajo date e deri ne mbajtjen e seancës përgatitore por edhe pas mbajtjes se te njëjtës nuk ka parashtrua përgjigjeje ne padi.

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

Lidhur me këtë çështje kontestimore gjykata ka caktuar seancë me datë 07.02.2023, në të cilën seancë përfaqësuesja e palës paditëse, ka theksuar se mbetet pranë kërkesëpadisë, mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material, nuk e kundërshtojmë ekspertizën e ekspertit pasi që e njëjta në tërësi ka vërtetuar se kalkulimi nga ana e KEDS-it është bërë në mënyrë të saktë andaj qëndrojmë pranë kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit në vlerën prej 4.869,74 € dhe lidhur me ekspertizën nuk kemi vërejtje dhe të njëjtën e mbështesim edhe ne si palë paditëse. **nga Prizreni deklaron:** mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material, i propozojmë gjykatës që të administrohen provat si në padi dhe provat tjera dhe propozojmë gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia. Lidhur me aktgjykimin penal P.nr.106/16 për kundër fakti që këtu i padituri Rr. A. është refuzuar akuza lidhur me vlerën e dëmit prej 4.679.79 €, i propozojmë gjykatës që të nxirret ekspertiza lidhur me kalkulimin të rikthimit të humbjeve për dëmin e shkaktuar ndaj paditëses KEDS nga i padituri Rr. A. Për ekspert propozojmë S. G. nga Prishtina që të bëjë ekspertizën nga ana e elektros lidhur me këtë çështje juridike kontestimore.

I padituri në seancën përgatitore nuk është deklaruar rreth padisë e pastaj gjatë seancave të shqyrtimeve kryesore nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën e vet asnjë herë nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesja e palës paditëse në fjalën e tij përfundimtare paraqitur kësaj gjykate në formë të shkruar, ka theksuar: se mbetet pranë kërkesëpadisë, mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material Duke vepruar konform aktvendimit të lartpërmendur, deklarojmë se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së dorëzuar pranë kësaj gjykate me nr. të lëndës C.nr.69/20 si dhe pranë të gjitha deklarimeve të theksuara në seancat e mbajtura lidhur me këtë çështje kontestimore, e duke i propozuar Gjykatës Themelore Prizren - Dega në Dragash që të nxjerr Aktgjykim sipas të Cilit duhet ta aprovojë në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit KEDS Sh.A.Në bazë të provave të administruara vërehet qartë se i padituri është shpallur fajtor në procedurë penale sipas vendimit të po kësaj gjykate P.nr.114/16 të dt. 21.03.2018, në bazë të të Cilit ai e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare. Sa i përket aktgjykimit P.nr. 106/16 me të cilin është refuzuar akuza, theksojmë se për të njëjtin kemi vërejtje, ashtu siç kemi deklaruar në seancën e dt. 09.10.2023, në rrethanën që gjykata në rastin konkret është vënë në lajthim nga këtu i padituri, për arsye se ndaj të paditurit janë iniciuar dy kallëzime penale dhe atë për dy shifra të konsumatorit DPZ... dhe DPZ, ku për njërin rast është ngritur aktakuza

me nr. PP/II.nr.1648-3/16 e dt. 03.08.2016 (që lidhet me Aktgjykimin P.nr.1 14/16) dhe aktakuza PP/II.nr.1649-3/16 e dt. 19.07.2016 (që lidhet me aktgjykimin P.nr.106/16). Si pasojë e kësaj, në rastin e dytë gjykata edhe në arsyetim ka theksuar se rasti "përgjason" me rastin e mëhershëm që ka pasur këtu i padituri duke e konsideruar çështjen si res judicata. Andaj, si palë paditëse konsiderojmë që aktgjykimi në fjalë, përkatësisht refuzimi i akuzës nuk duhet të ndikojë në vendimin e gjykatës lidhur me bazën dhe lartësinë e padisë dhe kërkesëpadisë. Faktin se i padituri i ka shkaktuar dem paditësit nga keqpërdorimi i energjisë elektrike e vërtetojnë provat e propozuara në padi, e të cilave i propozojmë gjykatës të i falë besimin, siç janë: Procesverbali nr. 1395561 dt. 27.02.2016, Procesverbali nr. 1395563 datës. 27.02.2016, Procesverbali Nj.Org. 02.nr. 4918 i dl. 01.04.2016, Kalkulimet e RH me ID t rasteve: 42023 dhe 42022, që të dyja të datës. 05.04.2016, Fatura DPZ16HP10666 e datës. 07.04.2016 (në shumën 4, 679. 796),

I padituri në kuptim të nenit 136, par. I të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve¹ ka për obligim që dëmin e shkaktuar ndaj paditëses ta kompensoj dhe se i njëjti në asnjë rast nuk ka mundur t'ia dëshmojë gjykatës se dëmi i shkaktuar ndaj paditëses KEDS Sh. A ka rrjedhur pa fajin e tij.

Andaj, mbi këtë bazë kërkojmë nga ana e Gjykatës padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoje në tërësi si të bazuar, duke e DETYRUAR paditësin që në emër të kompensimit të dëmit ta kompensojë paditësen në vlerën prej 4.869,74 (katërmijë e tetëqindtë e gjashtëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e katër cent), të gjitha këto me kamatë ligjore 8%⁰ në vit nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

definitive. Gjithashtu, në kuptim të nenit 452, par. 1, 463, par. I të LPK-së² i kërkojmë të gjitha shpenzimet procedurale dhe ato ne emër të pagesës se taksës për padi në Vlere prej 40.00 si dhe shpenzimet në emër të ekspertizës në vlerën prej 150, të gjitha këto ne shumën totale prej 190,00. (në shumën 189.956), kalkulime të cilat janë bërë konform rregullores dhe procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të miratuara nga ZRRE-ja. Një gjë te tillë e vërteton edhe ekspertiza e ekspertit të elektroteknikes S. G. e (Ët. 11.08.2023 ku konstaton se kemi te bëjmë me keqpërdorim apo shfrytëzim të paautorizuar te energjisë elektrike nga këtu i padituri Rr. A. A. Ndër të tjera edhe eksperti ka ardhur në përfundimin se kalkulimet dhe faturimet për rikthimin e humbjeve që janë bërë nga KEDS janë të sakta!

Bazuar nga te gjitha provat e lartcekura, vërtetohet baza e padisë dhe kërkesëpadisë, e ne këtu rast i padituri në kuptim të nenit 136, par. I të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve¹ ka për obligim që dëmin e shkaktuar ndaj paditëses ta kompensoj dhe se i njëjti ne asnjë rast mik ka mundur t'ia dëshmoj gjykatës se dem i shkaktuar ndaj paditëses KEDS Sh. A ka rrjedhur pa fajin e tij. Andaj, mbi këtu baze kokrojmë nga ana e Gjykatës padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoje ne tërësi si të bazuar, duke e DETYRUAR paditësin që ne emër të kompensimit të dëmit ta kompensoje paditësen ne vlerën prej 4.869,74 (katërmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë katër cent), te gjitha këta me kamatë ligjore 8⁰/0 ne vit nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Gjithashtu, në kuptim të nenit 452, par. 1, 463, par. I të LPK-së i kërkojmë të gjitha shpenzimet procedurale dhe ato në emër të pagesës se taksës për padi në vlere prej 40.00euro si dhe shpenzimet ne emër të ekspertizës ne vlerën prej 150, të gjitha këto ne shumën totale prej 190,00 euro

Gjykata ka tentuar qe palës se paditur ti dërgohet parashtrësia e datës 20.10.2023 dhe atë me datë 30.10.2023 por pa sukses pasi qe i njëjti nuk është hasur ne shtëpi ku ky konstatim është nga dorëzuesi i thirrjeve .

Provat e administruara

Në seancën e datës 09.10..2023 janë administruar këto prova: Lexohet përmbajtja e ekspertizës elektrike të ekspertit Sabri Grajqevci, të dt. 11.08.2023, Lexohet përmbajtja e Aktgjykimit P.nr.106/16, Lexohet përmbajtja e kallëzimit penal të dt. 20.06.2016, ku janë bashkangjitur dokumentet dhe atë procesverbali nr. 1395561 të dt. 27.10.2016, procesverbali NJ.org.02.nr.4918 të dt. 04.04.2016, kalkulimi i RH dt. 05.04.2016, procesverbali nr. 1395563 të dt. 27.02.2016, shikimi në foto dokumentacion, kalkulimi RH i dt. 05.04.2016 me përmbajtje tjetër, lexohet përmbajtja e faturës DPZ16HP10666 të dt. 07.04.2016, lexohet përmbajtja e faturës DPZ16HP10667 të dt. 07.04.2016, bëhet shikimi në foto dokumentacion dhe atë në 8 kopje ku shifet njehsori elektrik. Bëhet shikimi dhe lexohet përmbajta e Aktgjykimit P.nr. 114/16 të dt. 21.03.2018, bëhet shqimi në transaksionet e konsumatorit shifra DPZ-9016535 të dt. 06.02.2023 duke filluar nga periudha 31.12.2012 deri me dt. 10.02.2023 si dhe lexohet përmbajtja në transaksionet e konsumatorit shifra DPZ-.... të dt. 06.02.2023 duke filluar nga periudha 31.12.2012 deri me dt. 10.02.2023

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku me çka vendosi që si në dispozitiv të këtij aktgjykimi se, kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht si e bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Ndërsa nga Aktgjykimin penal P.nr.106/16 te datës 15.11.2018 dhe Aktgjykimin penal P.nr.114/16 te datës 21.03.2018, i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në ne Dragash e, i plotfuqishëm me date 18.04.2018, gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri në procedurë penale pranë kësaj gjykate e ka pranuar fajësinë se i njëjti e ka keqpërdorur njehsorin elektrik. Për gjykatën pra në këtë çështje kontestimore duke

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

u bazuar nga kjo provë nuk ka qenë kontestuese çështja e bazës së kërkesëpadisë por vetëm çështja e vlerësimit të shumës së dëmit në vlerë prej 4,869.74 euro.

Nga e Ekspertiza e ekspertit të elektro-teknikes S. G., e datës 11.08.20231, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri me veprimet e tij, palës paditëse i ka shkaktuar dëmin në shumën prej 4.869,74 euro duke sqaruar se Duke u bazuar nga kalkulimet e departamentit të rikthimit të humbjeve që është bërë në bazë të procesverbalit me nr-1395561 i datës 27.02.2016 e ku Llogaritja është bërë në bazë të fuqisë totale të pajisjeve dhe nenit 14.dhe 15 të rregullores së tyre eksperti konstaton se: Llogaritja për pajisjet totale në amvisëri ,

Poqa 15x20W	P1 -300W
shporet elektrik	P2=7500W
Friz -	P3 __ 250W
Tupan	P4=2500W
Thithese elektrike	P5 _ 1800W
Hekur -	P6=1000W
7 .Boiler	_P7=2000W

Ndërsa Llogaritja e pajisjeve totale në restorant është si në vijim

1 .Poqa -ndriçim 6x40W P1 -240W,Nxemje qendrore P2=24000W, Friz...250W

FurreP4=6000W,.Boiler...P5=2000W. Pra kalkulimet e fuqisë janë të sakta që janë bërë nga KEDS-si për keqpërdorim të energjisë elektrike nga konsumatori Rr. A. dhe KEDS-si se pari kalkulimin e rikthimit të humbjeve për energjinë elektrike që janë përpiluar janë të sakta e pastaj edhe faturimin e ka nda sipas tarifave verore dhe dimërore që kanë qenë aktive në atë kohë në vitin 2016 për konsumatorin komercial e që e ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga njehsori i amvisërisë. Në foton I- shihet rikthimi i humbjeve për tarifën verore dhe dimërore. Në foton 2 është paraqitur fatura e konsumatorit Rr. A. e ku shihen ndarjet që janë bërë sipas tarifave me çmime si dhe ato verore dhe dimërore. Në faturën e prezantuar shihet që kalkulimet që janë bërë janë të sakta dhe në bazë të ligjeve në fuqi të miratuara nga ZRRE-ja. Kalkulimet e energjisë janë të sakta e që janë bazuar në rregulloren . Ky ekspert në procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike të miratuar nga ZRRE-ja, gjithashtu është bërë edhe kalkulimi i saktë i faturave dhe është ndarë nga fatura e RH faturimi i rregullt që I është bërë konsumatorit Rr. A.. Në përfundim ky ekspert duke u bazuar në të gjitha shënimet e ofruar-dëshmitë dokumentet nga Gjykata ,llogaritja nga KEDS-si , si dhe nga konstatimet e ekspertit mund të përfundojmë se : I padituri: Rr. A. me nrp- 2030700867 nga fshati KUK-e, Komuna e Dragashit eksperti mendon se ka keqpërdorur energjinë elektrike duke u bazuar nga raporti i AMR dhe Kalibrimi i njehsorëve i datës 04.04.2016 me nr-4918, kalkulimet e fuqisë dhe faturat janë të sakta që janë bërë nga KEDS si për energjinë elektrike ashtu edhe për tarifën e energjisë, konsumatori Rr. A. me shifrën DPZ-9025304 që ka qenë objekt banimi —në kategorinë e amvisërisë kalkulimi I energjisë dhe faturimi nga KEDS-si është bërë saktë. Konsumatori Rr. A. me shifrën DPZ-.... që ka qenë objekt afarist —në kategorinë e komerciale kalkulimi I energjisë dhe faturimi nga KEDS-si është bërë saktë. Pra , ekspertiza në lidhje me rikthimin e humbjeve si dhe ngarkimi për konsumatorin që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar konstaton se kalkulimet dhe faturimet për rikthimin e humbjeve që janë bërë nga KEDS-si janë të sakta.

Kësaj prove - ekspertizës së ekspertit gjykata ia ka falur besimin pasi që e njëjta ishte e bazuar edhe në provat si pjesë e ekspertizës si dhe nga sqarimet në ekspertizë .

Nga përmbajtja e kallëzimit penal të dt. 20.06.2016, gjykata vërteton këtë kallëzim i janë bashkangjitur dokumentet –provat tjera si: procesverbali nr. 1395561 të dt. 27.10.2016, procesverbali NJ.org.02.nr.4918 të dt. 04.04.2016(kontrolli i njehsorit në qendrën e kalibrimit), kalkulimi i RH dt. 05.04.2016, procesverbali nr. 1395563 të dt. 27.02.2016 lidhur me kontrollin detal të njehsorit dhe evidenca e pajisjeve , nga foto dokumentacion, kalkulimi RH i dt. 05.04.2016,e faturës DPZ16HP10666 të dt. 07.04.2016, totali prej 4,679,79 euro të rikthimi i humbjeve), faturës DPZ16HP10667 të dt.

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

07.04.2016 (totali prej 189.95 të rikthimi i humbjeve), nga foto dokumentacion dhe atë në 8 kopje ku shihet njehsori elektrik, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu i padituri e ka keqpërdor energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar dhe është ngarkuar nga ana e palës paditëse në emër të rikthimit të humbjeve në shumën prej 4.869,74 euro dt. 07.04.2016.

Nga përmbajtja e Aktgjykimit P.nr.106/16, gjykata vërteton se ndaj të pandehurit është refuzuar aktakuza për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-es me arsyetim se i akuzuari për të njëjtën veprë penale është gjykuar me aktgjykim të formës së prere që mban shenjen P.nr.114/18 të datës 21.03.2018

Nga përmbajtja e Aktgjykimit P.nr.114/16, gjykata vërteton se i pandehuri është shpall fajtor dhe gjykuar me aktgjykim të formës së prere për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës me arsyetim se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barre me aktakuzë, me q rast i pandehurit është gjykuar me dënim të kushtëzuar me gjobe dhe me kusht. Me këtë aktgjykim pala e dëmtuar këtu KEDSI është udhëzuar në kontest civil juridik për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Ndërsa provës tjetër Mendimit nga ekipi profesional i KEDS-it, e datës 27.02.2016, DPZ, me numër 1395561 lidhur me kontrollin detal të njehsorit dhe evidenca e pajisjeve gjykata nuk ia fali besimin pasi që e njëjta është hartuar nga ana e personave të cilët janë në me numër marrëdhënie pune pranë palës paditëse, ku gjykata për më tepër e mori si qëndrim të paditurës se sa mendim profesional.

Baza ligjore

Gjykata konsideron se baza e padisë dhe kërkesëpadinë ndaj palës së paditur, është e mbështetur sipas nenit 136 paragrafi 1, të LMD-s, i cili thotë se, citojmë: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Kurse çështjen e dëmit, bazën e kërkesëpadisë, gjykata në këtë çështje gjyqësore e ka vërtetuar mbi bazën e Aktgjykimit penal P.nr. 114/2018 i datës 21.03.2018, i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Dragash, i plotfuqishëm.

Sa i përket së parë të aktgjykimit gjykata vendosi konform nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se, citojmë: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Pra sipas interpretimit të kësaj dispozite ligjore nga ana e gjykatës, vihet në përfundim se këtu i padituri gjatë shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale e ka pranuar fajësinë sipas Aktgjykimit penal P.nr. 114/2018 i datës 21.03.2018, i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Dragash, i plotfuqishëm 18.04.2018 Andaj për gjykatën nuk ka qenë më kontestuese fakti se i padituri a i ka shkaktuar dëm palës paditëse apo jo.

Ndërsa në lidhje me kamatëvonesën ligjore në shumë prej 8%, si dhe për njohjen e shpenzimeve procedurale të paditësit, gjykata veprimi konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Kurse gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës gjyqësore, ku e ka obliguar të paditurin të bart shpenzimet e procedurës në shumën të përgjithshme prej 190,00 euro dhe atë: prej 40 euro për pagesën e taksës gjyqësore, si dhe shumën prej 150,00 euro në emër të ekspertizës konform nenit 452.1 të LPK-s.

Andaj, duke marrë në konsideratë të gjitha këto nga sa u theksuan si më lartë, e duke vepruar konform nenit 14, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:103656

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 05285720

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:103656, 20.11.2023**

G j y q t a r i

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.